



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAÇ/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>3599</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>63</u>		
Data/Datum/Date <u>6 /12 /23</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024



PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Nenit 6 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Zyra për Informim në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal të Rahovecit, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

Për Projekt-Planin e Punës së Kryetarit të komunës për vitin 2024

Me 7.11.2023, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për **Projekt-Planin e Punës së Kryetarit për vitin 2024**. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike. Në të njëjtën ditë janë njoftuar përmes emailit drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, ndërsa përmes rrjetit social viber janë njoftuar kryetarët e fshatrave-lagjeve të komunës dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.

1. Publikimi në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/11/Projektplan-i-punes-se-kryetarit-te-komunes-dhe-qeverise-komunale-2024.pdf>
2. Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna/posts/pfbid029h51JG5tTTPskR2JtFWAzDdWR38G9g6ELnqcX5QXjFc9SuvsAttSfo3xAY7UHiPEl>
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41627>

4. **Me 20.11.2022**, në uebfaqe zyrtare dhe në facebookun e komunës, është publikuar rikujtimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik, në të njëjtën ditë përmes emailit rikujtimi i njoftimit u është dërguar, drejtorëve të shkollave, OJQ-ve sportive dhe OJQ-ve kulturore. Rikujtimi i njoftimit OJQ-ve sportive, OJQ-ve kulturore dhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve u është dërguar edhe përmes rrjetit social viber.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: **21.11.2023** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, kryetarët e këshillave të fshatrave, drejtorë të shkollave, përfaqësues të OJQ-ve, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Në ueb faqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/11/Projektplan-i-punes-se-kryetarit-te-komunes-dhe-qeverise-komunale-2024.pdf>

Konsultimi publik filloi në orën 10:00.

Konsultimin e shpalli të hapur Shefi i Kabinetit, Ali Morina e cili në pika të shkurtëra prezantoi Planin e Punës së Kryetarit, me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe



zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Ali Morina-

Përsëritet të gjithëve, të nderuar mirë se keni ardhur sot në konsultimin

publik për Planin e Punës së Kryetarit për vitin 2024. Plani i punës është në konsultim publik nga 07 nëntori deri më 07 dhjetor 2023. Të gjithë ju që doni të jepni kritika dhe sugjerime atë mund ta bëni

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

duke shënuar në adresat zyrtare të cekura në njoftim i cili është publik në ueb faqe dhe faqen zyrtare në facebook. i nderuar nënkryetarë, drejtorë, të nderuar të pranishëm.

Komuna e Rahovecit respektivisht grupi punues për përgatitjen e Projekt planit të punës së kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale 2024, duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Nenit 6 pika 1.1 të Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon njoftimin publik lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt planin e punës së kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale 2024.

Ashtu siç edhe po e shihni në projektor janë paraqitur zotimet e kryetarit, Komunës e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;

Komunë që qeveriset drejtë dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;

Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;



Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;

Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira si dhe standardet e larta të qeverisjes;

Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;

Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;

Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;

Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;

Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;

Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identiteti i Rahovecit;

Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;

Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;

Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

Bujqësia;

Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;

Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;

Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;

Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;

Investime nga fondi i efikasitetit të energjisë në sektorin publik dhe privat;

Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;

Promovimi i potencialit dhe mundësive për investime nga mërgata jonë;

Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe lirisë.

Poashtu janë edhe prioritetet e kryetarit.

Edukim dinjitoz i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore,

Mjedis të përshtatshëm arsimor,

Funksionalizim i plotë i çerdheve ekzistuese;

Bursa për student;

Përkrahje e fermerëve me serra, stalla, ferma të vogla, inpute dhe pajisje bujqësore;

Rrugë fushore;

Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;

Kanale të kullimit të tokave bujqësore;

Shërbime veterinarë periodike, falas;

Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;

Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;

Në bashkëpunim me KEDS, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj;

Bashkëpunim me KRU “Gjjakova” dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;

Efienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të mileniumit;

Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta;
Trajtimi i ujërave të zeza dhe rrugëve në pjesë problematike të qytetit;
On stop shop.

E shume të tjera.

Synimet janë:



Bujqësi të përkrahur;

Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;

Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;

Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;

Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrrenjve;

Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;

Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;

Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;

Hartimi i planeve urbane;

Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;

Po ashtu janë paraqitur edhe planet e zyreve të kryetarit dhe drejtorive përkatëse, gjithsej 12 drejtori. Unë nuk do isha zgjatur më shumë po ju lë juve fjalën nëse dikush ka ndonjë koment.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

Vjollce Gërgula: Përshëndetje për të gjithë, faleminderit që jemi pjesë e këtij takimi. Unë prej Qebdres Rinore kam vetëm falenderime për mbështetjen e vazhdueshme ku ne si partner serioz e kemi komunën.

Gresa Kastrati: Përshëndetje, jam nxënëse e shkollës Selajdin Mullabazi Mici, kërkesa ime është për një shetitje njëditore në Shqipëri për të parë nga afër se si zhvillohet mësimi në një shkollë profesionale atje.

Afrim Krasniqi (përfaqësues i fshatit Pastasel) – Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit, ju falenderoj për punët e përfunduara në fshatin tonë këto vitet e fundit dhe presim që edhe projektet tjera në bazë të kërkesave tona të realizohen..

Murat Morina (përfaqësues i fshatit Malësi e Vogël) – Përshëndetje të nderuar, falënderoj drejtorinë e kultures për investimet, ka ende për tu bër dhe shpresoj që viteve në vazhdim të përfundojnë.



Leonis Rama- nxënës në shkollën Selajdin Mullabazi Mici, desha të flas për gjendjen e zhveshtores së shkollave, mungëpnë disa gjëra elementare si dyer, drita etj.

Erza Berisha (nxënëse) – Kërkesa ime është që të kemi siguri në shkolla sepse shumë herë ka ndodhë që në shkollë vijn persona të panjohur dhe nuk ndihemi të sigurt.

Muharrem Morina – Të nderuar, deshta të shpreh një shqetësim të familjarëve të dëshmorëve, të vendoset shenjëzimi i ndalim parkingjeve para lapidareve.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

Saranda Morina, nxënëse- Kërkesa ime është të kemi psikolog në shkollë sepse na mundësonë trajtimin e rasteve të ndonjë problemi.

Kujtim Sopjani, përfaqësues i fshatit Dobidol – Ju përshëndes të gjithëve, vetem deshta të përgëzojë ekzekutivin për investimit në fshatin tonë, rregullimin e kanalizimit, rregullimin e kanaleve të ujrave atmosferik. Kërkesa ime është përfshirja në projekt e lagjes Berisha.

Afrim Dina – Përshëndetje të gjithëve dhe faleminderit që jeni sot këtu me ne, sa i përket themelimit të teatrit, ne kemi bërë gurmehelin e Qendres Rinore e Kulturore në Rahovec tani do të kemi hapësira të mjaftueshme me përfundimin e atij objekti. Rahoveci ka nevojë për teater por në mungesë të infrastrukturës të cilën e kemi patur. Do të vazhdojmë me mbështetjen e OJQ-ve. Sa i përket zhveshtores në sallën e sportit, do të shohim mundësitë buxhetore.

Ali Morina- sa i përket zhveshtores, ne e kemi një kontratë për mirëmbajtjen e objekteve publike, do ta trajtojmë me seriozitet kërkesen tuaj. Për sigurinë në shkollë, kryetari mban takime periodike me KKSB-në, është e pamundur të kemi sigurim fizik në secilën shkollë, por do të kërkojmë nga drejtorët e shkollave të rrisin fokusin në këtë drejtim. Te qështja e psikologëve, ne kemi të angazhuar disa psikolog, por fatkeqësisht numri nuk është i mjaftueshëm.

Sai përket shenjësimit tek lapidaret e dëshmorëve, drejtori i financave është menaxher i kontratës për sinjalizim horizontal dhe vertikal, e lusim drejtorin të kujdeset për këtë qështje dhe të vendosen shenjat te këto lapidare.

Tek vizita studimore, bëjeni një kërkesë zyrës së kryetarit, ne në konsultim me DKA-në do të ju mundësojmë viziten për këtë qëllim

Konsultimi përfundoi në 10 e 40.

Zyra për Informim

